



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 400/05-23821

Datë: 15.12.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 13 dhe 58 pika a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, si dhe në bazë të rekomandimit të datës 17.11.2023 të Komisionit Vlerësues për Ndarjen e Bursave Komunale të Komunës së Gjakovës për vitin akademik 2022/2023, me datën 15.12.2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi i Komisionit Vlerësues për Ndarjen e Bursave Komunale për studentët e Komunës së Gjakovës për vitin akademik 2022/2023, sipas regjistrimit të dhënave të bashkangjitura në këtë vendim.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të realizoj procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerën totale prej 20,400.00 € nga linja e subvencioneve të Drejtorisë për Arsim, me të cilat do të mundësohet pagesa e bursave për tridhjetë e katër (34) studentë të evidentuar në procesverbalin e komisionit dhe në listën e bashkangjitur të këtij vendimi.
3. Përfituesit e konkursit plotësues të bursave për vitin akademik 2022/2023, duhet të nënshkruajnë kontratë me Drejtorinë e Arsimit me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve si lartësia e bursës, mënyra e pagesës, si dhe kriteret për vazhdimin e bursës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë së Arsimit
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës

